

Bivsevic: Shumë çështje të hapura në rajon, misioni ynë kërkon kohë

Rudina Hoxha

Shqipëria, rol parësor në bashkëpunimin rajonal

"Europa Juglindore në udhëkryq historik"



Hido Bivsevic, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit për Bashkëpunim Rajonal (KBR), me qendër në Sarajevë, Bosnje-Hercegovinë

përbashkëta; ekonomitë tona kanë prirjen të mbështeten tek njëra-tjetra. Këshilli ka ende mjaft për të bërë në drejtim të mandatit bazë që konsiston në ndihmesën ndaj vendeve aspirante të Bashkimit Europian për arrijtjen e objektivit të tyre dhe gjithashtu në promovimin e integritimit Euro-Atlantik në rajon. Për sa u takon efektive të krizës së Eurozonës, patjetër që ato janë të ashpra - mbi të gjitha, ekonomitë tona janë të ndërlidhura me tregun ekonomik dhe financiar të Bashkimit Europian, kështu që ardhja tek ne e kësaj krize ishte një çështje kohe dhe përmase.

Si i koordinon përpjekjet e saj Këshilli për Bashkëpunim Rajonal me BE-në për të ndihmuar vendet aspirante të arrijnë objektivin e tyre final - integrimin?

Më lejoni t'i përgjigjem

TIRANA

Mund të them me kënaqësi të madhe se Shqipëria është shumë aktive dhe mbështetëse në aspektin e bashkëpunimit rajonal. Në shumë fusha, nga infrastruktura tek iniciativat si e SEE, Tirana është midis anëtarëve kryesorë

1 DEKADË

Jam i sigurt që ju e vutë re, se unë përdora fjalën "kur" dhe jo "nëse". Shpresoj se fjala "kur" do të marrë më pak se 10 vite.

kësaj pyetjeje me një ilustrim. Së fundmi, bëra një krahasim midis Strategjisë dhe Programit të Punës 2011-2013 të Këshillit, kërkesave të detajuara të Paketës së Zgjerimit të Komisionit Europian dhe listës së gjatë të kërkesave që vendet aspirante nga rajoni duhet të plotësojnë gjatë rrugës së tyre të anëtarësimit. Dhe doli se pothuajse 80 për qind e Programit tonë të Punës mbulon tashmë listën e kërkesave që vendet aspirante duhet të plotësojnë. Kështu, në shumë fusha prioritare - dhe në veçanti në drejtësi dhe në çështjet e brendshme, sundimi i ligjit, media e të tjera - Këshilli ka krijuar një platformë në ndihmë të vendeve aspiruese për t'u përgatitur akoma më mirë për bisedimet me Bashkimin Europian nëpërmjet një pune të përbashkët në këto fusha. Për më tepër, ne jemi duke diskutuar me Komisionin Europian, në veçanti me Drejtorinë e Përgjithshme për Zgjerimin, mënyrat për të rritur rolin e Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal në procesin e zgjerimit.

Ju lutem, a mund të ndani me ne disa nga mësimet që Këshilli ka nxjerrë lidhur me pengesat

që vendet aspirante kanë hasur në rrugën e integritimit, në mënyrë që ky proces të ecë më shpejt për vendet që janë para këtij procesi?

Mësimet e nxjerra gjatë kësaj rruge, fuqishëm tregojnë se në shumë fusha që kanë të bëjnë me bisedimet e ardhshme të Bashkimit Europian, vendet e përfshira ndajnë të njëjtat ngjashmëri dhe mungesa. Nëse shikojmë Progres-Raportet e vendeve aspirante për në BE në këto vitet e fundit, duket qartë se ato ndajnë të njëjtat sfida në plotësimin e kushteve në fushën e drejtësisë dhe çështjeve të brendshme, në sundimin e ligjit, rritjen e kapaciteteve administrative, lirinë e medias e të tjera. Por ka edhe fusha të tjera, që nga bashkëpunimi për sigurim deri në çështjet e refugjatëve; nga tregtia tek migrimi, ku pengesat mund të kalohen më shpejt në sajë të bashkëpunimit.

Me syrin e një ish-diplomati dhe gazetari, si i shikoni zhvillimet e fundit në Europën Juglindore? Si ka kontribuar Këshilli në arrijtjen e objektivave të këtij rajoni?

Mendoj se Europa Juglindore është në një udhëkryq historik, në veçanti nëse vëmë re paqen ende të paar-

ritur të Ballkanin Perëndimor. Vendimet e fundit të Këshillit Europian - që konfirmuan anëtarësimin e Kroacisë, fillimin e bisedimeve për anëtarësim të Malit të Zi qershorin e ardhshëm, si dhe dhënien e një mundësie Serbisë për të konfirmuar kapacitetin e saj të plotë Europian dhe konsensusin politik rreth këtij qëllimi, - patjetër që e mbajnë perspektivën dhe dinamikën e BE-së të hapur dhe në lëvizje të vazhdueshme në të njëjtën kohë.

Por gjithashtu ka shumë çështje të mbetura pezull që pengojnë ecjen përpara të çështjeve të tjera. Gjithashtu, rendi i ditës ndryshon vazhdimisht, prioritetet e reja kanë dalë në plan të parë, ndërkohë që ekziston një rrezik i qartë, sipas së cilës disa pjesë të rajonit mund të bien në një status quo të stërgjatë, që kanë të bëjnë me çështjet e ngrira.

Kjo fatkeqësisht mbart një potencial negativ, jo vetëm në aspektin e arrijtjes së paqes, por edhe në aspektin e stabilitetit dhe sigurisë, për të mos për mendur rrezikun më të madh - atë të krijimit të një çekuilibri strategjik kohë-marrës në rajon apo edhe një vakum strategjik nga pikëpamja Euro-Atlantike.

Ku pozicionohet Shqipëria në kontekstin e bashkëpunimit rajonal në Europën Juglindore?

Mund të them me kënaqësi të madhe se Shqipëria është shumë aktive dhe mbështetëse në aspektin e bashkëpunimit rajonal. Në shumë fusha, nga infrastruktura tek iniciativat si e SEE, Tirana është midis

BASHKËPUNIMI

Dhe nëse mund të hyjë tek sfera e vlerësimit politik, mendoj se bashkëpunimi politik i Shqipërisë me vendet fqinje ndihmon në ruajtjen e një atmosfere të favorshme në periudhat e sfidave të mëdha

anëtarëve kryesorë. Dhe nëse mund të hyjë tek sfera e vlerësimit politik, mendoj se bashkëpunimi politik i Shqipërisë me vendet fqinje ndihmon në ruajtjen e një atmosfere të favorshme në periudhat e sfidave të mëdha.

Në çfarë shkalle është përfshirë shoqëria civile në aktivitetet rajonale?

Shoqëria civile është posaçërisht e rëndësishme. Hyrja në BE dhe modernizimi i përgjithshëm i shoqërive tona nuk është dhe nuk duhet të jetë një detyrë vetëm e politikanëve. Për këtë arsye, Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal ka njohur rëndësinë e bashkëpunimit me shoqërinë civile. Tashmë, në dy raste, ne kemi realizuar bashkëpunimin midis Lëvizjeve Europiane nga rajoni dhe përfaqësuesit e tyre u ftuan në Samitin e Procesit të Bashkëpunimit të Europës Juglindore (SEEC) në Mal të Zi. Në të njëjtën kohë, ne bashkëorganizuam dhjetorin e kaluar, një konferencë të rrjetëve të organizatave të shoqërive civile në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi, për të diskutuar një pjesëmarrje me të madhe në proceset integruuese të Bashkimit Europian dhe zbatim të Strategjisë dhe Programit të Punës së Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal.

Një nga librat e shumtë që ju keni shkruar është edhe "EU for YOU" ("BE-ja për Ty"). Sipas pikëpamjes suaj, kush është rruga më e përshtatshme për t'u shprehur njerëzve tigrimin?

Duke kujtuar se si ne vepuam me Kroacinë në fillim të procesit të anëtarësimit tonë, mendoj se është e rëndësishme të ndash një panoramë të plotë dhe një të vërtetë të plotë rreth BE-së me të gjitha segmentet e shoqërisë.

Mbaj mend se ne e printuam librin "BE-ja për Ty" në mënyrë që çdo qenës në shkollë fillore të kishte mundësi ta kishte një kopje falas, ta merrte në shtëpi dhe të intrigohte prindërit dhe gjyshërit e tyre me të. Ekzistonte një mjedis vibrant rreth BE. Ky është vetëm një shembull që tregon se ideja e BE duhet të futet thellë në shoqëri dhe jo të mbetet thjesht një "lojë" vetëm e klasës politike.

Ku e shikoni Këshillin në 10 vjet, si dhe objektivat e tij?

Siç e thashë, edhe kur t'i zgjidhim të gjitha çështjet e lidhura me anëtarësimin e vendeve tona në BE dhe kur ky rajon të jetë stabilizuar plotësisht, si dhe kur rajoni ynë të jetë si çdo pjesë tjetër e Europës, ende do të ketë nevojë për bashkëpunim. Jam i sigurt që ju e vutë re, se unë përdora fjalën "kur" dhe jo "nëse". Dhe shpresoj se fjala "kur" do të marrë më pak se 10 vite.